

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2020 (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 17/19 data 24 dhjetor 2019), Kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për**  
**NDARJEN E BURSAVE PËR SPORTISTË – NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME**  
**NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT**  
**për vitin 2020**

**I**

Qyteti i Shkupit vazhdon me mbështetjen për zhvillimin dhe avancimin e sportit rinor dhe shkollave të mesme, dhe me dhënien e bursave për sportistë – nxënës të shkollave të mesme, që janë banorë të qytetit të Shkupit dhe të cilët mësojnë në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren për dhënien e bursave për sportistë – nxënës të shkollave të mesme në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit, do të jepen bursa për sportistë, nxënës dhe nxënës nga shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Të drejtë për fitimin e bursës kanë:

1. Nënshetas të RMV-së
2. Banor/e e Shkupit (10 komuna në territorin e Qytetit të Shkupit);
3. Nxënës/e të rregullta ose të çrregullta në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit;
4. Sportist/e aktive, anëtar/e e klubit sportiv nga territori i qytetit të Shkupit të regjistruar në Federatën kombëtare sportive amë të Maqedonisë;
5. Arritje të larta sportive gjatë vitit 2019 dhe në vitin 2020, deri në përfundimin e Thirrjes publike, të aplikuesve që aplikojnë për herë të parë.
6. Arritje të larta sportive gjatë vitit 2019 nga data 14.02.2019 dhe në vitin 2020 deri në përfundimin e Thirrjes publike, të aplikuesve të cilët më parë kanë fituar bursë nga Qyteti i Shkupit.

Këta bursistë, do të fitojnë bursë me vlerë të përgjithshme neto 24.000,00 denarë gjatë vitit në vijim 2020.

**II**

Aplikuesit, përveç dokumenteve të lartpërmendura, në fletëparaqitjet e depozituara duhet t'i plotësojnë qëllimet dhe kriteret që janë dhënë të bashkëngjitura me Thirrjen publike që është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit. [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)

**III**

Në procedurën e ndarjes së bursave nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2020, në procesin e përzgjedhjes do të hyjnë aplikues – nxënës të shkollave të mesme, sportiste dhe sportistë, të cilët në bazë të kriterëve do të sigurojnë më së paku 50 pikë, nga gjithsej 100 pikë të mundshme.

#### IV

Aplikimi në Thirrjen publike kryhet me depozitim të fletëparaqitjes së veçantë të plotësuar, e cila mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)

Aplikuesit, përveç fletëparaqitjes në mënyrë të detyrueshme duhet t'i depozitojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

- kopje e letërnjoftimit të prindërit/kujdestarit;
- kopje nga certifikata e lindjes e aplikuesit;
- vërtetim nga shkolla e mesme ku aplikuesi është nxënës i rregullt ose i çrregullt në vitin shkollor 2019/2020;
- kopje nga dëftesa për vitin shkollor 2018/2019 të përfunduar;
- biografi e shkurtër e aplikuesit ;
- vërtetim nga klubi sportiv se është anëtar i të njëjtit;
- vërtetim nga Federata kombëtare sportive amë se është anëtar i përfaqësues së gjeneratës së tij;
- aplikuesit të cilët vitin e kaluar kanë marrë bursë nga Qyteti i Shkupit, të depozitojnë vërtetim nga Federata kombëtare sportive amë për arritjen e rezultateve sportive nga data 14.02.2019, deri në përfundimin e Thirrjes publike në vitin 2020.
- aplikuesit të cilët për herë parë kanë aplikuar për marrjen e bursës, të depozitojnë vërtetim nga Federata kombëtare sportive amë për arritjen e rezultateve sportive nga data 01.01.2019, deri në përfundimin e Thirrjes publike në vitin 2020

#### V

Thirrja publike zgjat **gjithsej 32 ditë**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Thirrja publike shpallet më **27.12.2019** dhe zgjat deri më **27.01.2020**.

Fletëparaqitjet duhet të depozitohen deri te Qyteti i Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. „Ilinden” nr. 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më 27.01.2020 deri në orën 19:00 të ditës së fundit nga përfundimi i Thirrjes publike, me emërtimin: **Për “THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSAVE PËR SPORTISTË–NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT”**.

Fletëparaqitjet duhet të depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shenja të aplikuesit, i cili depoziton fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta të cilat nuk janë depozituar në mënyrën siç kërkohet në tekstin e lartpërmendur, përkatësisht përmbajnë të dhëna jo të plota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merrni në telefonin: 02/ 3297-238 dhe 3297-320.

**QYTETI I SHKUPIT**